



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË –KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE/
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE

Drejtoria e Planifikimit Urban



Numër dhe datë e protokollit:	05 Nr.112 dt.10.03.2021
Referencë	Kërkesa nr.05-345/03-0008838/21 dt.26.02.2021
Për /Za/To:	"AL PETROLL" Shpk , Hasime Kryeziu
Nga/Od/From	Drejtori i Planifikimit Urban: Dr. Sc. Abdulla Prebreza
Punoi:	Fatime Ismajli ark.
Tema/Subjekti/Subjek	Përgjigje në ankesë

Drejtoria e Planifikimit Urban ka pranuar kërkesën e juaj nr nr.05-345/03-0008838/21 dt.26.02.2021 lidhur me komentet në Njoftimin publik të datës 16.02.2021 për kushtet ndërtimore të propozuara për ndërtim të objektit me karakter të përkohshëm pompë e karburanteve, të aplikuesit "Orange Group" SH.P.K. me pronar Elhami Hajdari në parcelat kadastrale nr.72514009-664-8, pjesë e parcelës P-72514009-706-18 dhe parcela nr.72514009-665-1 ,ZK Sllatinë e Madhe pronë e PSH Industria e Drurit dhe Pylltarisë ,menaxhuar nga Agjencia e Pyjore të Kosovës .

Pas shqyrtimit të komenteve të juaja dhe provave të bashkangjitura me ankesë ju njoftojmë se:

1. Komuna e Fushë Kosovës ka miratuar Harten Zonale Komunale 2020-2028 me dt 05.08.2020 nr.100 dhe zbatimi I tij ka filluar me 01.09.2020 . Destinimi I parcelave në fjalë është Zonë Industriale ,i njeiti destinim është dhënë edhe Njoftim mbi destinimin e dt.08.02.2021.për pjesët e parcelave 706-18 dhe 664-1që I keni ju në shfrytëzim.
2. Parcelat kadastrale për zhvillim: parcela nr.72514009-664-8, pjesë e parcelës P-72514009-706-18 dhe parcela nr.72514009-665-1 ,ZK Sllatinë e Madhe pronë e PSH Industria e Drurit dhe Pylltarisë ,menaxhuar nga Agjencia e Pyjore të Kosovës ,nuk janë pjesë e parcelave që keni ju në shfrytëzim por tangjentohen me parcelat e juaja. (Inqizimi gjeodezik i prezentuar)
3. Ministria e Bujqësisë ,Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Agjencioni Pyjor i Kosovës ka paisur "Orange Group" SH.P.K. me :
 - a. Kontratë për cedim ,22.01.2020 (nga kontrata bazë për qiranë e tokës pyjore e dt.14.12.2016 e lidhur me OE"Joos&Krasniqi –BAZE "SHPK,) me aktivitet të shitjes së karburanteve me shumicë dhe pakicë si dhe prodhimi dhe përpunimi i aktiviteteve hoteliere,
 - b. Vërtetim 30.12.2020 për mundësinë e vazhdimit të kontratës,
 - c. Aktvendim për bartje të kontratës dhe obligimeve të dt.23.01.2020



pyjore me qira i dt.16.07.2018 për OE”Joos&Krasniqi –BAZE
“SHPK,

4. Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit ka lëshuar Pëlqim Mjedisor për pompën e derivateve të dt.06.08.2020 për parcelën nr. 72514009-665-1.
5. Ministria e Infrastrukturës ,Departamenti i Menaxhimit të rrugëve në lidhje me parcelën nr. 72514009-1029-0, ka njoftuar se :”nuk është kompetencë të saj pasi që parcela në fjalë është rrugë e pa kategorizuar.
6. UA 08/2017 të MMPH Normat teknike të planifikimit hapësinorë ,UA 06/2017 të MMPH për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore leje ndërtimore dhe nuk përcaktojnë kritere specifike për distancë mes objekte të të njëjtit destinim ,kriteret e përcaktuara kanë të bëjnë me distancë maksimale 1H të objektit më të lartë në rrethinë.
 - a. Distanca mes objekteve me destinim pompë e karburanteve nuk është e përcaktuar as në UA të MTI ,për kushtet teknike për import,deponim,shitje me shumicë,shitje me pakicë të karburanteve të naftës dhe pastrim të rezervuarëve dhe UA 15/20 i MTI për ndryshim dhe plotësim e UA (MTI) 06/2019.,për kushte teknike për import ,deponimin,shitjes me shumicë,shitje me pakicë të karburanteve të naftës dhe pastrim të rezervuarve.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër kësaj përgjegje mundë të paraqitet ankesë Komisionit për ankesa të Komunës dhe MMPH të në afatin prej 30(tridhjetë) ditësh nga dita e publikimit.

